

UDHËZIM Nr. 5, datë 23.2.2021

**PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM
NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 3.4.2020,
“PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 47, të ligjit nr. 87/2019, datë 18.12.2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Neni 1

Në nenin 20, “Regjistrimi i faturave në librin e shitjes dhe librin e blerjes”, të udhëzimit nr. 16, datë 3.4.2020, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, bëhen disa shtesa dhe një ndryshim si më poshtë:

a) Në pikën 11, pas paragrafit të parë shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Nëse blerësi që ka refuzuar faturën, kryen pagesën e plotë apo të pjesshme të faturës së refuzuar nëpërmjet sistemit bankar, atëherë kjo faturë çmohet automatikisht e pranuar dhe regjistrohet në librin e blerjes së blerësit pavarësisht refuzimit paraprak.

Faturat e fiskalizuara nga subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e telekomunikacionit, sigurimeve, furnizimit të energjisë elektrike dhe ujit për konsumatorët finalë, si dhe faturat mujore të lidhura me kontrata afatgjata *leasing* dhe fatura të ngjashme me to, të cilat lëshohen në mënyrë të vazhdueshme dhe mbi bazën e një kontrate afatgjatë të lidhur paraprakisht nga palët, do të çmohen të fiskalizuara automatikisht dhe pavarësisht statusit të blerësit nëse është aktiv apo pasiv.”.

b) Pika 13 riformulohet si më poshtë vijon:

“Të dhënat nga librat e blerjeve dhe shitjeve të evidentuara deri në ditën e dhjetë të muajit pasardhës, nëse nuk janë deklaruar nga ana e tatimpaguesit, do të deklarohen automatikisht.

Këto të dhëna do të përdoren për të plotësuar dhe kontabilizuar deklaratën e TVSH-së së muajit respektiv, pavarësisht nëse tatimpaguesi ka konfirmuar ose jo këto të dhëna.”.

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe fillon të zbatohet në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj